



**Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri**

---

**Public Affairs and Media Office**  
*Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe e Medias*

**DEKLARATË PËR SHTYP**

**Drejtori i OSBE/ODIHR-it bën thirrje për diskutime gjithëpërfshirëse për ndryshime në procesin zgjedhor**

TIRANË, 18 nëntor 2005 – Ambasadori Christian Strohal, Drejtori i Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) theksoi sot nevojën që Shqipëria të marrë nën zotërim të plotë pronësinë shqiptare të çdo diskutimi dhe vendimi që ka për qëllim përmirësimin e sistemit zgjedhor në vend.

Së bashku me Jørgen Grunnet, Kryetar i Misionit të përfunduar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të këtij institucioni (MVZ), ai ishte në Shqipëri për dy ditë pas publikimit të raportit përfundimtar të vëzhgimit të zgjedhjeve për zgjedhjet e mbajtura më 3 korrik të këtij viti.

Gjatë takimeve me Presidentin Alfred Moisiu, Kryeministrin Sali Berisha, Kryetaren e Kuvendit Jozefina Topalli, Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Ilirjan Celibashi, dhe Kryetarin e Partisë Socialiste, Edi Rama, delegacioni i OSBE/ODIHR-it dëgjoi komentet mbi përfundimet dhe rekomandimet e këtij raporti, si dhe diskutuan mënyrat e përmirësimit të mëtejshëm të procesit zgjedhor.

"Shqipëria ndodhet përballë disa alternativave themelore, që askush tjetër nuk mund t'i zgjedhë në emër të saj", tha Ambasadori Strohal. "Këto kanë të bëjnë, në veçanti, me nevojën për eliminimin e mundësisë së shtrembërimit të parimit të proporcionalitetit. Ne besojmë thellësisht në pronësinë shqiptare të një procesi të tillë, i cili duhet të jetë politikisht gjithëpërfshirës dhe i efektshëm."

Drejtori i ODIHR-it mirëpriti gatishmërinë e aktorëve politikë me të cilët u takua Delegacioni për ndërmarrjen e diskutimeve konstruktive, si dhe iniciativën e Presidentit për organizimin e një tryeze lidhur me këtë çështje.

"ODIHR-i dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri janë të përgatitura për të ndihmuar me ekspertizë teknike kur të jenë bërë zgjedhjet e alternativave themelore," tha Strohal.

---

Për më shumë informacion, ju lutemi, kontaktoni **Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun dhe të Medias të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri**, Rr. Donika Kastrioti, Vila 6, Tiranë, Shqipëri, tel: +355 4 235 993, faks: +355 4 244 204, e-mail: [pamo-al@osce.org](mailto:pamo-al@osce.org), adresa në Internet: [www.osce.org/albania](http://www.osce.org/albania)

Ai mirëpriti, gjithashtu, qëllimin e qeverisë për fillimin e një projekti ambicioz për përmirësimin e regjistrimit të gjendjes civile, duke shtuar se një përpjekje e tillë do të kërkojë si përkushtim afatgjatë, ashtu edhe burime të konsiderueshme, në mënyrë që të sigurohet një sistem plotësisht funksional në kohë përpara zgjedhjeve parlamentare të 2009-s, paralelisht me vazhdimin e punës për përmirësimin e listave të zgjedhësve për zgjedhjet e qeverisjes vendore.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, së bashku me OSBE/ODIHR-in, është e gatshme ta mbështesë këtë sipërmarrje, para së gjithash, për vlerësimin e nevojave dhe hartimin e një plani realist.

Për më shumë informacion, ju lutemi, kontaktoni **Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun dhe të Medias të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri**, Rr. Donika Kastrioti, Vila 6, Tiranë, Shqipëri, tel: +355 4 235 993, faks: +355 4 244 204, e-mail: [pamo-al@osce.org](mailto:pamo-al@osce.org), adresa në Internet: [www.osce.org/albania](http://www.osce.org/albania)